



AUTORITETI KONTRAKTOR

BASHKIA FIER

Njësia e Prokurimit

Adresa : Lagja "Kastriot", Rruga "Brigada e XI Sulmuese"; Tel/Fax : 034 410 636

Nr. _____ Prot.

Fier, më 30/05/2017

Lënda : Formulari i Njoftimit të Fituesit për tenderin "Rehabilitim i fasadave dhe rik i rr R.Nallbani dhe rrjetëzim i terminalit të autobuzeve"

**AGJENCISE SE PROKURIMIT PUBLIK
TIRANE**

BASHKIA FIER

[Data: 30/05/2017]

Për: **O.E A.L-Asfalt shpk**; Adresa ; Xhafzotaj, Komuna Xhafzotaj, Kryqezimi 4 Rruget, Durres

Procedura e prokurimit: **Procedura e Hapur me mjete elektronike.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rehabilitim i fasadave dhe rik i rr R.Nallbani dhe rrjetëzim i terminalit të autobuzeve"** Fier, Shqipëri, sipas Projektit dhe Preventivit të miratuar të cilat janë pjesë e dokumentave të tenderit.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qene pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **"A.L-Asfalt sh.p.k."**, përkatësisht numri i NIPT-it K81511508A

Vlera totale sipas preventivit **118 674 808 lekë** (nëqind e tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tete) **pa TVSH dhe me TVSH 142 409 769 lekë** (nëqind e dyzet e dy milion e katërqind e nente mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nente).

2. Operatori ekonomik **"Boshnjaku.B sh.p.k."**, përkatësisht numri i NIPT-it K72627402H

Vlera totale sipas preventivit **pa TVSH 110 455 262 lekë** (nëqind e dhjetë milion katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) dhe **me TVSH 132 546 314 lekë** (nëqind e tridhjetë e dy milion pesëqind dyzet e gjashtë mijë e treqind e katërmëdhjetë).

3. Operatori ekonomik **"Shendelli" shpk**, përkatësisht numri i NIPT-it K07924803N

Vlera totale sipas preventivit **0 lekë.**

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtem:

1. O.E "Shendelli" sh.p.k NIPT-it K07924803N
2. O.E "Boshnjaku B shpk NIPT-it K72627402H

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik "Shendelli" sh.p.k

I mungon i gjithë dokumentacioni ligjor, teknik, ekonomik e financiar i kerkuar nga AK. Mungon formulari i ofertes dhe preventivi i punimeve.

2. Operatori ekonomik "Boshnjaku B sh.p.k"

- Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST në pikën 2.3/4 të DST kërkohet që shoqëritë për fabrikën e asfaltit duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë, Leje Mjedisore. Nëse nuk është në pronësi duhet të paraqitet kontrata e furnizimit (e lidhur para noterit) me poseduesin e fabrikës së asfaltit e shoqëruar me dokumentin e pronësisë, Leje Mjedisore nga organet kompetente. Vendndodhja e fabrikës duhet të jete jo më shumë se 20 km nga vendndodhja e objektit që prokurohet.

Operatori ekonomik "Boshnjaku B". shpk ka paraqitur kontratë furnizimi me nr. rep.2582 dhe nr. kol. 1496, datë 22.07.2014, midis shoqërisë "Boshnjaku B". shpk dhe shoqërisë "Albanian Art of Konstruktion". shpk me objekt "furnizim me binder dhe asfalto beton". Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit përcaktohet "vendndodhja e fabrikës nuk duhet të jetë më shumë se 20 km nga vendndodhja e objekti që prokurohet". Shoqëria "Albanian Art of Konstruktion" shpk është me vendndodhje Lushnje, Lagja "Loni Dhamo", e cila rezulton të jetë më larg se 20 km nga objekti që prokurohet. Kjo mangësi është në kundërshtim me pikën 2.3/4, të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Për këtë arsye kjo shoqëri s'kualifikohet nga kjo procedure.

Ne DST është kërkuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim. Operatori nuk plotëson një nga kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST.

- Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST pika 2.3 Kapaciteti teknik kërkohej përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

Punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme të së njëjtës natyrë në një vlerë prej jo më pak se 59 600 478 lekë (një shumë jo më e lartë se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit;;

Ose

Punë të ngjashme ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit është të paktën një vlerë prej 238 401 912 leke. (jo më shumë se sa dyfishi i vlerës së kontratës që do të prokurohet);

Nga shoqëria Boshnjaku B janë paraqitur punë të kryera si më poshtë:

1. Rehabilitimi i rrjetit kanalit ujitës të rezervuarit Shishtavec
2. Ndërtimi i K.U.Z fshati Velmish
3. Ndërtim Pallati
4. Rikonstrukcioni i shkollës 9 vjeçare Riza Ibrahimi
5. Ndërtim Trotuari, Bashkia Roskovec
6. Rehabilitim i linjës së dërgimit të ujës jellës në qendrat e banuara Dushk
7. Investim projekt linje ABC në rrjetin TU 0.4 KV për kabinat Orikum
8. Rikonstrukcion i rrugës topoje-shenpjeter
9. Rehabilitim i urrës së Grykshit.

Nga verifikimi i preventivave të paraqitura në punët e ngjashme nga shoqëria Boshnjaku B rezulton se në kjo shoqëri në asnjë rast nuk dëshmon se ka kryer punë me shtrim asfalto betoni. Në punën e

paraqitur Rikonstruksioni i rrugës Topoj-Shenpjeter shoqëria Boshnjaku B ka kryer sistemim me çakëll dhe rërë bituminoze.

Për këtë arsyeje operatori ekonomik s'kualifikohet pasi nuk plotëson piken 2.3 Kapacitetit teknik te DST

Ne DST eshte kerkuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim. Operatori nuk plotëson një nga kriteret e e veçanta te kualifikimit te kërkuara ne DST.

- Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST pika 2.2 të kapaciteti ekonomik dhe financiar kerkohet “Një vërtetim të gjendjes financiare nga një bankë që vërteton se shoqëria ka në llogari rrjedhese një shume jo më pak se 11 920 095 leke (jo më pak se 10 % e fondit limit që prokurohet), leshuar jo më vonë se 10 dite përpara hapjes së ofertave si dhe të jenë perfshire nr. llogarise, Iban dhe NIPTI i shoqërisë”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria Boshnjaku B rezulton se ky subjekt ka paraqitur një vërtetim bankar ku gjendja aktuale e llogarisë është 4.308.216 leke dhe 9.366 €.

Ne DST është kërkuar që shoqëria të paraqesin një vërtetim të gjendjes financiare nga një bankë në vlerën 11.920.095 lekë. Shoqëria Boshnjaku B nuk e plotëson këtë pikë të DST, për këtë arsyeje kjo shoqëria s'kualifikohet nga kjo procedure.

Ne DST eshte kerkuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim. Operatori nuk plotëson një nga kriteret e e veçanta te kualifikimit te kërkuara ne DST.

- Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST pika 2.3.2 kerkohet që shoqëria duhet të ketë në stafin e tij inxhinieret si më poshtë :
 - Inxhinier –Auditues energjie 1(një) (i pajisur me “Certifikatë për auditimin e energjisë).

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se shoqëria Boshnjaku B nuk ka paraqitur asnjë dokument ku të vërtetoj se ka pjesë të stafit të vetë një inxhinier të pajisur me certifikatë për auditimin e energjisë. Për këtë arsyeje ky operator s'kualifikohet nga kjo procedure pasi nuk plotëson një nga kërkesat e DST.

Ne DST eshte kerkuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim. Operatori nuk plotëson një nga kriteret e e veçanta te kualifikimit te kërkuara ne DST.

- Sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST pika 2.3/5 kerkohet që shoqëria duhet të jetë e pajisur edhe me certifikatat e mëposhtme:
 - Certifikate :Sistemi i menaxhimit të cilësive (ISO 9001 2008) për tregtim fidane, farera, drurë e shkurre dekorative, fidanishte etj.)
 - Certifikate : Sistemi menaxhimit të mjedisit (ISO 14001 për tregtim fidanë, farëra, drurë e shkurre dekorative, fidanishte etj.)
 - Certifikate konformiteti 0407- CPD-515(IG036-2012)(shtyllat, krahët e ndriçimit)
 - Certifikate e menaxhimit të cilësipërbojën elektrostatische ISO 9001 -2008

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e APP, shoqëria Boshnjaku B nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetoj se zotëroni certifikatat e kërkuara në piken 2.3.5 të DST. Për këtë arsyeje ky operator s'kualifikohet nga kjo procedure.

Ne DST eshte kerkuar se: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim. Operatori nuk plotëson një nga kriteret e e veçanta te kualifikimit te kërkuara ne DST.

Duke iu referuar proceurës së lartpërmendur, informojmë **O.E “A.L-Asfalt” shpk** me Adrese: Xhafzotaj, Komuna Xhafzotaj, Kryqezimi 4 Rruget, Durrës, se oferta e paraqitur me vlerë totale sipas preventivit **pa TVSH 118 674 808 lekë** (njqind e tetembedhjetë milion e gjashtëqind e shtatedhjetë e kater mije e teteqind e tete) dhe me **TVSH 142 409 769 lekë** (njqind e dyzet e dy milion e katerqind e nente mije e shtateqind e gjashtedhjetë e nente), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Njesise se Prokurimit se Bashkise Fier, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Brigada e XI Sulmuese”**, sigurimi e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtedhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **19.05.2017**.

Ankesa: ka ose jo, - **Jo**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë

Konc.L.Zeka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Armando SUBASHI

